



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i Informatikës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, (FSHN) shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel akademik me kohë të plotë, të kategorisë lektor:

Kriteret e përgjithshme e të veçanta të kandidatit të kategorisë lektor janë si më poshtë:

I.1. Kriteret e përgjithshme të kategorisë lektor

1. Kandidati duhet të mbajë gradën shkencore Doktor (Lektor) në: Inxhinieri Kompjuterash; Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit; Informatikë; Informatikë Ekonomike; Inxhinieri Software; Inteligjencë Artificiale; Sisteme Informacioni; Siguri Informacioni; Shkenca Kompjuterike, ose degë të përafërta me të. (Grada shkencore e mbrojtur nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë i njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri;
2. Kandidati të ketë përfunduar studimet universitare (Master i Shkencave dhe Bachelor) dhe/ose ekuivalente me të, në fushat e kërkuara. (Diplomat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë i njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri;
3. Kandidati të zotërojë të paktën një nga pesë gjuhët e huaja të Bashkimit Europian;
4. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masa disiplinore të largimit nga puna;
5. Kandidati të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;

I. 2. Kriteret e veçanta për kandidatin e kategorisë lektor janë si më poshtë:

1. Të ketë përvojë dhe të jetë i angazhuar në mësimdhënie në Institucionet e Arsimit të Lartë;
2. Të ketë përvojë në fushën e kërkimit shkencor dhe projekteve;
3. Të ketë kryer kualifikime brenda dhe jashtë vendit në fushat përkatëse.

Kandidatët duhet të dorëzojnë, pranë zyrës së protokollit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim (plotësim i formularit të aplikimit, i cili gjendet në faqen: www.uniel.edu.al).
2. Jetëshkrimi (CV).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

3. Kopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave. Diplomat e lëshuara nga Institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga MAS.
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësimit të kritereve të shpallura.
5. Kopje e librezës së punës/vërtetim punësimi nga punëdhënësi për ekperiencën e punës
6. Dëshmi e gjuhëve të huaja të noterizuar.
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti).
8. Raport i aftësisë për punë.
9. Fotokopje e letërnjoftimit.
10. Librezë shëndetsore.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (28.09.2026 – 07.10.2026) nga data e shpalljes në www.uniel.edu.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *personel akademik, koha e plotë*
Departamenti i Informatikës (FSHN)
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit Shkencave të Natyrës. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (12.10.2026 – 30.10.2026). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.